



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosova



Komuna e Drenasit/Gllogocit
Opština Gllogovac
Municipality of Drenas

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
06/111-5568
Dt.06.02.2024

Në bazë të nenit 77 parag.1 dhe nenit 80 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 8 i Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, si dhe konform U.Adm.07/2017 për rregullimin e procedurave të Konkursit në sektorin publik, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr. Hafir Shala” - Komuna e Drenasit shpall:

KONKURS
PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

- Doktor i Mjekësisë – nëntë (9) vende të lira;
- Infermier në KPSH në QMF dhe AMF – tetë (8) vende të lira;
- Infermier/e të pajisur me patent shofer (urgjencë mjekësore- Drenas, Komoran) – shtatë (7) vende të lira;
- Asistent/e stomatologu – tre (3) vende të lira;
- Laborant në Komoran – një (1) vend i lirë;
- Teknik të RTG-së – tre (3) vende të lira (Drenas, Komoran);
- Shofer për nevoja të (shërbime) të QKMF-së – një (1) vend i lirë .

- I. **Titulli i vendit të punës: 9 (nëntë) Doktor i Mjekësisë në Kujdesin Parësor Shëndetësor (QKMF, QMF dhe AMF)**

Institucioni: QKMF “Dr.Hafir Shala” - Komuna e Drenasit/Gllogocit
Lloji i pozitës: Doktor I Mjekësisë - Nëpunës i Shërbimit Publik

Numri i Pozitave: Nëntë (9) – dy (2) në Shërbimin e Urgjencës në QKMF, një (1) në Shërbimin e Urgjencës në Komoran, një (1) në AMF Terstenik, një (1) në AMF Arllat, një (1) në AMF Nekoc, dy (2) në AMF Gllanasellë, një (1) në AMF Abri

Titulli i mbikëqyrësit: Shefit të Njesisë, Drejtorit të QKMF-së

Titulli: H10-Cd_247, **Grada:** H- H10-7.4

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pa caktuar.

Detyrat dhe Përgjegjësit për Doktor i Mjekësisë

Qëllimi i përkshkrimit të pozitës është përcaktimi i kompetencave të Mjekut të përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve shëndetësore gjithëpërfshirëse dhe efikase, të bazuara në dëshmi përmes bashkëpunimit dhe monitorimit të ngushtë nga ana e Mjekut Familjar. Mjek i përgjithshëm ka për detyrë të promovojë dhe përparojë shëndetin e individit , pacientit dhe familjes, duke pasur parasysh aspektin demografik dhe ambiental. Ofron kujdes gjithëpërfshirës dhe përkrahje psikosociale-fizike, për të gjithë pa dallim kulturë, besim, race , ngjyrë, gjini a moshë, statusi social, apo vlera të perceptuar ekonomike.

- Ofron shërbime me standard të lartë bazuar në mjekësn e bazuar në dëshmi ;
- Ofron shërbime gjithëpërfshirëse për individin/pacientin dhe familjen në të gjitha episode e jetës nën mbikqyrje të Mjekut Familjar;
- Harton dhe zhvillon planin e trajtimit të sëmundjes dhe trajton pacientin si figurë qendrore nën mbikqyrje të Mjekut Familjar;
- Përcakton diagnoz diferenciale dhe diagnozën e punës në përputhje me simptomatologjisë;
- Përcjellja sistematike e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve dhe adoloshentëve ;
- Kujdesi për personat e moshuar dhe në nevojë;
- Ofron kujdes për rastet urgjente dhe i referon rastet me kohë dhe në mënyrë adekuate;
- Interpretin rezultatet e testeve të shpejta laboratorike;
- Komunikon ose konsultohet me specialist të mjekësisë familjare sipas nevojës;
- Referon pacientin te specialist i mjekësisë familjare dhe për kujdes spitalor;
- Kujdesi i vazhdueshëm për pacientet me sëmundje kronike jo ngjitëse;
- Kontrolli i sëmundjeve ngjitëse (hulumtimet epidemiologjike);
- Promovimi shëndetësor dhe parandalimi i sëmundjeve si dhe shërbimet në komunitete(grupet vulnerable , vendet rurale, shkolla, komunitete);
- Zbatimi i programit të vaksinimit;
- Edukimi shëndetësor etj.

- Inkurajohet nga puna ekipore mjeku familjare, infermieret familjare, infermieret ne komunitet;
- Vlerëson efektin e kujdesit te ofruar nga ekipi i mjekësisë familjare, identifikon problemet dhe kerkon nga anëtarët e ekipit zgjidhjen e tyre;
- Përcaktohet nga mjeku familjare si pjesë e ekipit të mjekësisë familjare në përputhje me nevojat e pacientit, aftësitë dhe kualifikimet, për të përmbushur nevojat e institucionit;
- Merr pjesë në trajnime, vlerëson të kompetencave, orientom dhe edukim;
- Komunikon qartë , sakt dhe krijon klimë të mirë për punë që rritë knaqëshmëritë në punë;
- Kryen punë administrative, vepron në mënyrë profesionale, duke respektuar rregulloret për KPSH dhe vepron në përputhje me të gjitha rregulloret, procedurat dhe politikat e MSH në fuqi;
- Përcakton diagnozën përfundimtare dhe përshkruan terapinë;
- Nënshtrohet programit nacional të zhvillimit të vazhdueshem profesional;
- Përkujdeset për konfidencialitetin e individit;
- Përcjellja e sëmundëshmërisë nën mbikqyrje të mjekut familjar;
- Identifikimi i grupeve të veqanta të rrezikut;
- Merr pjesë në grupet e rishqyrtimit kolegjal dhe sjell vendime të përbashkëta për menaxhimin e sëmundjeve;
- Ndhmon mjekun familjar në zhvillimin e auditeve mjekësore në institucionin përkatës;
- Merr pjesë në takime, konferenca dhe tregon interesim në zhvillimin e strategjive për përmirësimin e intervenimeve klinike dhe nivelit të lartë të kujdesit ndaj pacientit;
- Demonstron shkathtësi optimale klinike profesionale;
- Tregon aftësi për zbatim të vazhdueshëm të detyrave të punës sipas PVP;
- Tregon përkushtim për ngritjen profesionale dhe përmirësim të kompetencave;
- Shkrimi duhet të jetë i qartë dhe i lexueshëm.

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve:

- Të jetë banorë i Republikës së Kosovës;
- Të ketë të kryer Fakultetin e Mjekësisë;
- Të jetë i /e regjistruar dhe licencuar në OMK;
- Të ketë ndjenjë përgjegjësie, i/e përkushtuar ndaj profesionit dhe ndryshimeve të këtë shkathtësi pune të pavarur dhe në ekip, si dhe shkathtësi të mira komunikimi;
- Të ketë njohuri të gjuhëve të huaja dhe të punës me kompjuter;
- Të ketë gatishmëri të punojë me të gjitha grupet, pa dallim moshe, gjinie, kulturë, etnike, religjioni apo race.

Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit i plotësuar;
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë) i fotokopjuar;
- Diplomat e kualifikimit e noterizuar ;
- Licenca e punës orgjinale (e noterizuar);
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nosrifikuara diplomat

Nga MASHT;

- Certifikata që nuk jeni nën hetime (orgjinal);
- Kandidatët të cilët përzgjidhen nga komisioni intervistues obligohen që brenda afatit para nënshkrimit të Kontratës të sjellë në Shërbimin e Administratës së QKMF-së certifikatën shëndetësore, në të kundërtën kontrata do të nënshkruhet me kandidatin e radhës për të cilin vlen gjithashtu e njëjta rregull.

II. INFIRMIER/E NË KPSH (QKMF, QMF dhe AMF)

Institucioni: QKMF “Dr.Hafir Shala” - Komuna e Drenasit/Glllogocit

Lloji i pozitës: Infermier në KPSH (QMF-AMF)

Numri i Pozitave: Tetë (8) – një (1) në AMF Sankoc, një (1) në AMF Arllat, një (1) në AMF Baicë dhe QKMF, një (1) në AMF Terstenik, dy (2) në QKMF Mjekësi Familjare, një (1) në AMF Nekoc, një (1) në QMF Komoran Mjekësi Familjare

Titulli i mbikëqyrësit: Shefit të njësisë, Kryeinfermierit/es/ Drejtorit të – QKMF-së

Titulli: H17- Cd_277 , Grada :H17

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pa caktuar

Detyrat dhe përgjegjësit për Infermier:

Qëllimi i përshkrimit të pozitës është përcaktimi i kompetencave për ofrimin dhe udhëheqjen e kujdesit infermieror dhe bashkëpunimit të ngushtë me anëtarët e ekipit të mjeksisë familjare. Infermieri/ja familjare (IF në KPSH ka për detyrë të promovojë dhe përpunojë shëndetin e individit -pacientit dhe familjes përmes ofrimit, delegimit, vlerësimit dhe bashkëpunimit gjithpërfshirës profesional të kujdesit sipas procesit infermieror, pa dallim moshe, gjinie, kulture, etnie, religjioni dhe race, duke ofruar perkrahje psikosociale dhe fizike për individin, pacientin dhe familjen. Infermieri/ja familjare është anëtar i ekipit të Mjeksisë Familjare, punon i-e pavarur dhe me ekipe multi-profesionale dhe sugjeron detyrat e riorganizuara në praktikë me qëllim të përmirësimit të performancës së institucionit në tërësi.

Kujdesi ndaj pacientit:

- Praktikon në përputhje me kodin etik dhe zbaton procesin e kujdesit infermier të dokumentuar;
- Reagon në mënyrë efektive për të papriturat ose ndryshon situatën me shpejtësi;
- Vlerëson, planifikon, zbaton dhe rivlerëson kujdesin infermieror të ofruar në përputhje me moshën, gjendjen fizike, psikosociale, kulturore dhe shpirtërore të individit pacientit dhe familjes, në pajtueshmëri me standardet e përcaktuara;
- Menaxhon rastet dhe avokon për të drejtat e tyre, duke qenë burim dhe person kontaktues për ta;
- Komunikon në mënyrë efektive me individin pacientin apo familjen dhe ofron kujdes të standardit të lartë dhe dokumenton punën e bërë;

- Ofron promovim dhe edukim shëndetësor për individin pacientin dhe familjen me theks të veçantë në marrjen e përgjegjësisë për vetëkujdes conform moshës dhe dhe nevojave të identifikuara;
- Grumbullon dhe dokumenton të dhënat subjective dhe objective për individin pacientin dhe rishqyrton informatat themelore të individit pacientit duke u përqendruar në ambientin ku jeton, vetëkujdesin dhe planifikimin e metutjeshëm;
- Ofron shërbime për të parandaluar sëmundjen dhe për të avancuar dhe promovuar jetë të shëndoshë dhe të sigurtë lidhur me shëndetin riprodhues dhe planifikimin familjar;
- Ofron shërbimet e kujdesit ante. Peri dhe post natal, imunizimin dhe vaksinimin, zhvillimin e fëmijëve, kujdesin për adoleshentë dhe të rinjë dhe shëndetin oral preventues;
- Ofron shërbime infermierore duke përfshirë kujdesin shtepiak për nëna dhe fëmijë me sëmundje kronike jo ngjitëse, shëndet mendor dhe kujdesin terminal paliativ;
- Përgatit dhomen e egzaminimit me paisje dhe furnizime të nevojshme të kërkuara për vizitë, njëherit asiston gjatë ekzaminimit dhe procedurave të kërkuara.
- Administron terrapin enterale dhe paraenterale, të përshkruara nga mjeku familjar, me shkathtësi dhe përpikmëri;
- Respekton masat aseptike gjatë marrjes së mostrave laboratorike përfshirë edhe kontrollën e kualitetit dhe mirëmbajtjen e të gjitha testeve të shpejta laboratorike diagnostike dhe informon menjëherë rezultatet me vlera jonormale të testeve laboratorike të ordinuara nga mjeku familjar;
- Përmban konfidencialitet të plotë për të gjitha qeshtjet që i përkasin individit pacientit dhe familjes, veprimtarisë së KPSH, përveq nëse është i-e autorizuar me shkrim nga menaxheri;
- Mbështet dhe kontribuon në hulumtime të kujdesit shëndetësor, që ndërlidhen me dëshmit për siguri dhe praktikën efektive që ndërlidhet me të gjitha vendet e punës infermierore duke përfshirë edhe vendet e punës e detyrat specifike si në intervencë, triazhim, kartotekë, recepcion, urgjencë-emergjencë, transport shëndetësorë , me komunitet, vaksinim-imunizim, SISH, shendet oral, radiologji etj.).

Detyrat e ekipit:

- Inkurajohet nga puna ekipore (mjeku familjarë, mjeku i përgjithshëm, stomatologu, infermierët familjar, infermierët në komunitetet dhe asistentin e stomatologut;
- Vlerëson efektivitetin e kujdesit të ofruar nga ekipi i mjekësisë familjare, identifikon problemet dhe ndihmon për zgjidhjen e tyre;
- Vepron në cilësinë e anëtarit të ekipit të mjekësisë familjare në përputhje me nevojat e institucionit për kujdesin sa më cilësor për individin pacientin dhe familjen;
- Merr pjesë në takime konsultative, profesionale, komunikonë qartë saktë dhe krijon klimë të mirë pune si dhe empati ndaj pacientit dhe familjarëve të tij.
- Është burim i njohurive dhe shkathtësive për anëtarë tjerë të ekipit për të shkëmbyer përvojat klinike.

Detyrat administrative:

- Vepron në mënyrë profesionale dhe në përputhje me të gjitha rregulloret, procedurat dhe politikat e MSH në fuqi për KPSH;
- Zbaton detyrat e deleguara nga menaxheri në pajtueshmëri me politikat shëndetësore në fuqi, gjithnjë duke ruajtur konfidencialitetin profesional;
- Punon dhe bashkëpunon me profesionistët tjerë shëndetësor në KPSH, duke përdorur mekanizmin për monitorimin e rezultatit të kujdesit ndaj individit pacientit dhe familjes;
- Identifikon rëndësinë e kërkimit për të përmirësuar rezultatet e shëndetit për individin pacientin;
- Realizon veprimin e duhur dhe të sigurtë, deponon dhe administron paisjet, harnat dhe të gjitha informatat klinike në mënyrë të duhur dhe me kosto efektive;

- Merr pjesë në zhvillimin dhe përpilimin e udhëzimeve dhe protokoleve të shkruara, procedurave për shërbime infermiere;
- Zbaton protokolet e praktikave infermiere të bazuara në dëshmi, mbledhje të dhënave në mënyrë sistematike dhe vlerëson të dhënat në aspektin fizik, socio-kulturor dhe mendon për shëndetin e individit pacientit dhe familjes;
- Merr pjesë në mbledhjet dhe aktivitetet e ekipit të mjekësisë familjare për të përmirësuar performancën e tij/saj dhe të institucionit.

Kushtet dhe kriteret për Infermierë:

- Diploma bachelor në Infermieri, e noterizuar;
- Licenca e punës lëshuar nga OIK e noterizuar;
- Të jetë banorë i Republikës së Kosovës;
- Dokumenti identifikues kopje;
- Certifikata e kandidatit që nuk është nën hetime-origjinali;
- Kandidatët të cilët përzgjidhen nga komisioni intervistues obligohen që brenda afatit para nënshkrimit të Kontratës të sjellë në Shërbimin e Administratës së QKMF-së certifikatën shëndetësore, në të kundërtën kontrata do të nënshkruhet me kandidatin e radhës për të cilin vlen gjithashtu e njëjta rregull.

Kualifikimet e preferuara për infermier:

- Të ketë ndjenja përgjegjësie i-e përkushtuar ndaj profesionit dhe ndryshimeve;
- Të ketë shkathtësi të mira të komunikimit;
- Të ketë njohuri të punës me kompjuter dhe gjuhëve të huaja;
- Të ketë gadishmëri të punoj me të gjitha grupet, pa dallim moshe, gjinie, kulture, etniciteti, religjioni apo race.
- Preferohet të ketë patentshofer.

III. INFERMIER FAMILJARË NË URGJENCË

Institucioni: QKMF “Dr.Hafir Shala” - Komuna e Drenasit/Glllogocit

Lloji i pozitës: Infermier në KPSH (QKMF-QMF)

Numri i Pozitave: Shtatë (7), katër (4) në QKMF Drenas, tre (3) në QMF Komoran

Titulli i mbikëqyrësit: Shefit të Emergjencës/ Kryeinfermierit/es/ Drejtorit të – QKMF-së

Titulli: H17- Cd_277 , Grada :H17

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar për periudhë (1) një vjeqare, me mundësi vazhdimi në kontratë të përhershme nëse të njëjtit kandidatë arrijnë që brenda periudhës një vjeqare të pajisen me certifikatë për drejtim të autoambulancës në Qendrën e Trajnimeve të Integruara në Studime të Vushtrisë (Ligji Nr. 05/L - 024 për Shërbimin Mjekësor Emergjent)

Detyrat dhe Përgjegjësisitë e Infermierit/es Familjarë në Urgjencë

PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM

Qëllimi i përshkrimit të pozitës është përcaktimi i kompetencave për ofrimin dhe udhëheqjen e kujdesit infermierik dhe bashkëpunimit të ngushtë me anëtarët e ekipit të mjeksisë familjare. Infermierija familjare (IF në KPSH ka për detyrë të promovojë dhe përpunojnë shëndetin e individit pacientit dhe familjes përmes ofrimit, delegimit, vlerësimit dhe bashkëpunimit gjithpërfshirës profesional të kujdesit sipas procesit infermieror , pa dallim moshe, gjinie, kulture, etnie, religjioni dhe race, duke ofruar perkrashje psikosociale dhe fizike për individin, pacientin dhe familjen. Infermieri-ja familjare është anëtar I ekipit të Mjeksisë Familjare, punon i-e pavarur dhe me ekiye multi-profesionale dhe sugjeron detyrat e riorganizuar në praktikë me qëllim të përmirësimit të performancës së institucionit në tërësi.

KUJDESI NDAJ PACIENTIT

- Praktikon në përputhje me kodin etik dhe zbaton procesin e kujdesit infermier të dokumentuar;
- Reagon në mënyrë efektive për të papriturat ose ndryshon situatën me shpejtësi;
- Vlerëson, planifikon, zbaton dhe rivlerëson kujdesin infermieror të ofruar në përputhje me moshën, gjendjen fizike, psikosociale, kulturore dhe shpirtërore të individit pacientit dhe familjes, në pajtueshmëri me standardet e përcaktuara;
- Menaxhon rastet dhe avokon për të drejtat e tyre, duke qenë burim dhe person kontaktues për ta;
- Komunikon në mënyrë efektive me individin pacientin apo familjen dhe ofron kujdes të standardit të lartë dhe dokumenton punën e bërë;
- Ofron promovim dhe edukim shëndetësor për individin pacientin dhe familjen me theks të veçantë në marrjen e përgjegjësisë për vetëkujdes conform moshës dhe nevojave të identifikuar;
- Grumbullon dhe dokumenton të dhënat subjektive dhe objektive për individin pacientin dhe rishqyrton informatat themelore të individit pacientit duke u përqendruar në ambientin ku jeton, vetëkujdesin dhe planifikimin e metutjeshëm;
- Ofron shërbime për të parandaluar sëmundjen dhe për të avancuar dhe promovuar jetë të shëndoshë dhe të sigurtë lidhur me shëndetin riprodhues dhe planifikimin familjar;
- Ofron shërbimet e kujdesit Ante, Peri dhe post natal, imunizimin dhe vaksinimin, zhvillimin e fëmijëve, kujdesin për adoleshentë dhe të rinjë dhe shëndetin oral prevenues;
- Ofron shërbime infermierore duke përfshirë kujdesin shtepiak për nëna dhe fëmijë me sëmundje kronike jo ngjitëse, shëndet mendor dhe kujdesin terminal paliativ;
- Përgatit dhomen e egzaminimit me paisje dhe furnizime të nevojshme të kërkuara për vizitë, njëherit asiston gjatë ekzaminimit dhe procedurave të kërkuara.
- Administron terrapin enterale dhe paraenterale, të përshkruara nga mjeku familjar, me shkathtësi dhe përpikmëri;
- Respekton masat aseptike gjatë marrjes së mostrave laboratorike përfshirë edhe kontrollën e kualitetit dhe mirëmbajtjen e të gjitha testeve të shpejta laboratorike diagnostike dhe informon menjëherë rezultatet me vlera jonormale të testeve laboratorike të ordinuara nga mjeku familjar;
- Përmban konfidencialitet të plotë për të gjitha qeshtjet që i përkasin individit pacientit dhe familjes, veprimtarisë së KPSH, përveq nëse është i-e autorizuar me shkrim nga menaxheri;
- Mbështet dhe kontribuon në hulumtime të kujdesit shëndetësor , që ndërlidhen me dëshmit për siguri dhe praktikën efektive që ndërlidhet me të gjitha vendet e punës infermierore duke përfshirë edhe vendet e punës

e detyrat specifike si në intervencë, triazhim, kartotekë, recepcion, urgjencë-emergjencë, transport shëndetësorë , me komunitet, vaksinim-imunizim, SISH, shendet oral, radiologji, Lab. etj.).

DETYRAT E EKITIT

- Inkurajohet nga puna ekipore (mjeku familjar, mjekun e përgjithshëm, stomatologun, infermierët familjar, infermierët në komunitetet dhe asistentin e stomatologut;
- Vlerëson efektivitetin e kujdesit të ofruar nga ekipi I mjekësisë familjare, identifikon problemet dhe ndihmon për zgjidhjen e tyre;
- Vepron në cilësinë e anëtarit të ekipit të mjekësisë familjare në përputhje me nevojat e institucionit për kujdesin sa më cilësor për individin pacientin dhe familjen;
- Merr pjesë në takime consultative, profesionale, komunikojnë qartë saktë dhe krijojnë klimë të mirë pune që të rritë knaqësit e individit pacientit dhe familjes;
- Është burim I njohurive dhe shkathtësive për anëtarë tjerë të ekipit për të shkëmbyer përvojat klinike.

DETYRAT ADMINISTRATIVE:

- Vepron në mënyrë profesionale dhe në përputhje me të gjitha rregulloret, procedurat dhe politikat e MSH në fuqi për KPSH;
- Zbaton detyrat e deleguara nga menaxheri në pajtushmëri me politikat shëndetësore jhnë fuqi, gjithnjë duke ruajtur konfidencialitetin profesional;
- Punon dhe bashkëpunon me profesionistët tjerë shëndetësor në KPSH, duke përdorur mekanizmin për monitorimin e rezultatit të kujdesit ndaj individit pacientit dhe familjes;
- Identifikon rëndësinë e kërimit për të përmirësuar rezultatet e shëndetit për individin pacientin;
- Realizon veprimin e duhur dhe të sigurtë, deponon dhe administron paisjet, harnat dhe të gjitha informatat klinike ne menyre të duhur dhe me kosto efektive;
- Merr pjesë ne zhvillimin dhe perpilimin e udhëzimeve dhe protokoleve të shkruara, procedurave për shërbime infermiore;
- Zbaton protokolet e praktikave infermiore të bazuara në dëshmi, mbledhje të dhënave në mënyrë sistematike dhe vlerëson të dhënat ne aspektin fizik, socio-kulturor dhe mendon për shëndetin e individit pacientit dhe familjes;
- Merr pjesë në mbledhjet dhe aktivitetet e ekipit të mjekësisë familjare për të përmirësuar performancën e tij-saj dhe të institucionit
- Ka qëndrim pozitiv drejt ndryshimeve në përmirësimin e kujdesit dhe ngritjen e cilësisë përmes IVM;

STANDARDET E PERFORMANCËS

- Demonstron shkathtësi klinike të larta profesionale;
- Tregon aftësi për zbatimin e detyrave të punës sipas PVP;
- Demonstron dhe mbështet standardet e persosëmërisë së shërbimeve sipas PVP;
- Tregon përkushtim për ngritje profesionale dhe përmirësim të kompetencave;
- Respekton plotësisht konfidencialitetin;
- Shkrimi duhet jetë I qartë dhe I lexueshëm.

DETYRAT SPECIFIKE për infermier/e në sektorin e urgjencës (Recepcion, Intervencë, Observim, transport dhe shofer në autoambulancë)

➤ **NË RECEPCION**

Detyrat dhe përgjegjësitë: të gjitha punët, detyrat e punes dhe përgjegjesite e infermierike, duke pase parasysh edhe përgjegjësitë specifike të vendeve të punes brenda sektorit si:

- Është përgjegjës për triazhimin e pacientëve urgjent;
- Kryen regjistrimin dhe protokollimin e pacientëve;
- Kryen pagesën e participimit sipas llojeve të shërbimeve përkatëse në bazë të dëftesës së dhënë dhe të evidentuar;
- Kujdeset që secilit pacient t'i ipet fletëpagesa për pagesën e kryer të shërbimit të ofruar;
- Përgjigjet në thirrje telefonike;
- Përgatit ordinancën e mjekut;
- Kryen edhe punët tjera sipas urdhërit të Kryeinfermierit të Urgjencës.
- Për punën e vet i përgjigjet Kryeinfermierit të Urgjencës;

➤ **NË INTERVENCË**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Aplikon terapinë të rastet urgjente, sipas urdhëresës së mjekut;
- Kryen fashimet dhe asiston te inetrvenimet e vogla;
- Sterilizon mjetet dhe materialin për fashime dhe intervenime të vogla;
- Zbaton dhe përdorë drejtë masat dhe mjetet mbrojtëse në punë;
- Mban evidencën për terapinë e aplikuar sipas reçetave të përshkruara;
- Në vazhdimësi kujdeset për sigurimin dhe plotësimin e antishok terapisë;
- Kontrollon afatin e skadencës së antishok terapisë;
- Sipas nevojës dhe urdhërave të përgjegjësit kryen edhe punët tjera të infermierit në Urgjencë;
- Për punën e vet i përgjigjet Kryeinfermierit të Urgjencës;

➤ **NË DHOMËN E OBSERVIMIT**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bën stabilizimin e gjendjes së pacientëve urgjent;
- Bën përcjelljen e gjendjes dhe terapisë së pacientëve të vendosur në dhomën e observimit;
- Kontrollon funksionimin e aparaturës në dhomën e observimit;

- Zbaton dhe përdorë drejtë masat dhe mjetet mbrojtëse në punë;
- Ndjekë trajnimet e vazhdueshme në ngritjen e shkathtësive në menaxhimin e rasteve urgjente;
- Bën përgatitjet sa më profesionale të pacientëve urgjent në raste të përcjelljes së tyre në Qendra më të avansuara;
- Sipas nevojës dhe urdhërit të përgjegjës kryen edhe punët tjera të Infermierit në Urgjencë;
- Për punën e vet i përgjigjet Kryeinfermierit të Urgjencës.

➤ **NË PËRCJELLJE TË RASTEVE GJATË TRANSPORTIT**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Është përgjegjës për transportimin e pacientëve nga shtëpia deri në Urgjencë si dhe deri në qendrat tjera më të avansuara;
- Bën aplikimin e terapisë si dhe përcjelljen e shenjave vitale gjatë kohës së transportit të pacientve;
- Bën bartjen e pacientëve prej shërbimit deri në autoambulancë dhe anasjelltas;
- Sipas nevojës dhe urdhërave të përgjegjës të shërbimit të urgjencës, kryen edhe punët tjera të Infermierit në Urgjencë;
- Ndjekë trajnimet e vazhdueshme në ngritjen e shkathtësive në menaxhimin e rasteve urgjente;
- Raporton përgjegjësin e parkut të automjeteve për gjendjen e autoambulancës dhe paisjeve mbrenda sajë.

➤ **Infermier-shofer NË TRANSPORTIN E RASTEVE ME AUTOAMBULLANCË**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bën transportimin e rasteve urgjente të pacientve në bazë të urdhëresës së personit të autorizuar (24) orë (Doktorit të sektorit urgjences ose shefit të sektorit);
- Mban evidencën në formularë të relacionit dhe kilometrat e kaluara
- Kryen punët ekipore në bartjen e pacientëve gjatë transportit;
- Aplikon aftësit profesionale së bashku me ekipin në vendin e ngjarjes
- Kujdeset për higjienën e autoambulancës pas rasteve të transportuara së bashku me ekipin.
- Mbikqyrë gjendjen aparaturës përcjellëse mjekësore në autoambulancë;
- Raporton të përgjegjësi i shërbimit për gjendjen e aparaturave në autoambulancë
- Raporton përgjegjësin e parkut të automjeteve për gjendjen e autoambulancës;
- Zbaton procedurat standarde në komunikacion gjatë drejtimit të autoambulancës
- Për punën e vetë i përgjigjet Kryeinfermierit të Urgjencës dhe bashkëpunon me përgjegjësin e parkut të makinave.
- Për gjendjen e Autoambulancës i përgjigjet personit përgjegjës të parkut të makinave.
- Zbaton procedurat e pranimi dorëzimit të ndërrimit të ekipa pasuese për gjendjen e autoambulancës dhe paisjeve mjekësore
- Kryen edhe trajnime shtesë nga infermiera ose ngasja e autoambulancave dhe mjeteve tjera motorrike të KPSH.
- Zbaton procedurat standarde të mirëmbajtjes dhe përdorimit të automjeteve zyrtare dhe autoambulancave në bazë të Rregullores të aprovuar nga institucioni.

Kushtet dhe kriteret për Infermierë në Urgjencë:

- Diploma bachelor në Infermieri, e noterizuar,
- Licenca e punës lëshuar nga –OIK e noterizuar,
- Të jetë banorë i Republikës së Kosovës;
- Patentën e shoferit drejtim manual kategoria B;
- Të ketë së paku dy (2) vite përvojë si vozitës;
- Dokumenti identifikues kopje,
- Certifikata e kandidatit që nuk është nën hetime-originali,
- Kandidatët të cilët përzgjidhen nga komisioni intervistues obligohen që brenda afatit para nënshkrimit të Kontratës të sjellë në Shërbimin e Administratës së QKMF-së çertifikatën shëndetësore, në të kundërtën kontrata do të nënshkruhet me kandidatin e radhës për të cilin vlen gjithashtu e njëjta rregull.
-

Kualifikimet e preferuara për infermier në Urgjencë:

- Të ketë ndjenja përgjegjësie i-e përkushtuar ndaj profesionit dhe ndryshimeve;
- Të ketë shkathtësi të mira të komunikimit;
- Të ketë shkathtësi pune i-e pavarur dhe ne ekip;
- Të ketë njohuri të punës me kompjuter dhe të gjuhëve të huaja;
- Të ketë gadishmëri të punoj me të gjitha grupet, pa dallim moshe, gjinie, kulture, etniciteti, religjioni apo race.

IV. INFERMIER / ASISTENT NË SEKTORIN E SHËNDETIT ORAL-Kartotekë/Triazhim / ekzaminime bazike radiologjike dentare

Institucioni: QKMF “Dr.Hafir Shala” - Komuna e Drenasit/Glllogocit

Lloji i pozitës: Asistent/e stomatologu në KPSH (QKMF-QMF-AMF)

Numri i Pozitave: Tre (3), një (1) në AMF Arllat, dy (2) në QKMF Drenas

Titulli i mbikëqyrësit: Shefit të Sektorit të shëndetit Oral, Kryeinfermierit/es, Drejtorit të – QKMF-së

Titulli: H17- Cd_277 , Grada :H17– me Bachelor

Titulli: H20-Cd_298, Grada: H20-5 – shkollë e mesme

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pa caktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë profesionale:

- Asiston në punën e mjekut stomatolog në Ordinanca Stomatologjike në kuadrin e Sektorit të Shëndetit Oral;
- Bashkëpunon me mjekun në promovimin e shëndetit oral, në kuadrin e Sektorit të Shëndetit Oral;
- Kryen ekzaminime rentgenologjike bazike intra-extraorale;
- Kujdeset për funksionimin dhe përdorimin e rregullt të aparaturës;
- Kujdeset për zbatimin dhe përdorimin e drejt të masave dhe mjeteve mbrojtëse në punë;
- Kujdeset për instrumentet dhe sterilizimin e tyre;
- Zbaton dhe përdorë drejtë masat dhe mjetet mbrojtëse në punë;
- Asiston gjatë punës së Stomatologut;
- Bashkëpunon me Kryeinfermierin e Sektorit të Shëndetit Oral;
- Kryen edhe punët tjera sipas urdhërit të Kryeinfermierit të Sektorit të Shëndetit Oral;
- Për punën e vet i përgjigjet Dr Stomatolog, shefit sektorit dhe Kryeinfermierit të Sektorit të Shëndetit Oral sipas orareve të percaktuara nga menagjimenti në cikël organizativ.

Detyrat dhe përgjegjësitë administrative:

- Kryen pranimin dhe triazhimin e pacientëve stomatologjik;
- Kryen pagesën e participimit për shërbimin e ofruar në bazë të dëftesës së dhënë dhe të evidentuar;
- Kryen hapjen dhe sistematizimin e kartelave stomatologjike;
- Kryen edhe punët tjera sipas urdhërit të Kryeinfermierit në Sektorin e Shëndetit Oral;
- Për punën e vet i përgjigjet Kryeinfermierit në Sektorin e Shëndetit Oral;

INFERMIER/ASISTENT I SHENDETIT ORAL NË KOMUNITET

- Bashkëpunon me mjekun në promovimin e shëndetit oral, në komunitet
- Ndihmon mjekun stomatolog në vizita sistematike të fëmijë deri në moshën 15 vjeq
- Zbaton udhëzimet e mjekut stomatolog në vizita sistematike të fëmijëve parashkollor dhe nxënësve në shkollë.
- Promovon edukimin shëndetësor të shëndetit ORAL dhe higjienës së gojës.
- Zbaton planin e veprimtimit për vizita sistematike
- Mban evidencën e rasteve të fëmijëve me karies dhe cakton terminet e trajtimit në sektorin e shëndetit oral.
- Mban ligjerata vëdisuese me komunitetin për shëndetin oral.

Kushtet dhe kriteret për Infermier/e asistent në Sektorin e Shëndetit Oral:

- Diploma, shkolla e mesme e mjekësisë- teknik i stomatologjisë, Bachelor (e noterizuar),
- Infermier me trajnime bazike radiologjike dentare (e preferuar);
- Licenca e punës lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë- OIK,
- Dokumenti identifikues kopje,
- Të jetë banorë i Republikës së Kosovës,
- Të ketë ndjenjë përgjegjësie, i/e përkushtuar ndaj profesionit dhe ndryshimeve të këtë shkathtësi pune të pavarur dhe në ekip, si dhe shkathtësi të mira komunikimi;
- Të ketë njohuri të gjuhëve të huaja dhe të punës me kompjuter;
- Të ketë gatishmëri të punojë me të gjitha grupet, pa dallim moshe, gjinie, kulturë, etnike, religjioni apo race;

Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit i plotësuar;
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë) i fotokopjuar;
- Diplomat e kualifikimit e noterizuar ;
- Licenca e punës orgjinale (e noterizuar);
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nosrifikuara diplomat Nga MASHT;
- Certifikata e kandidatit që nuk është nën hetime-origjinali,
- Kandidatët të cilët përzgjidhen nga komisioni intervistues obligohen që brenda afatit para nënshkrimit të Kontratës të sjellë në Shërbimin e Administratës së QKMF-së certifikatën shëndetësore, në të kundërtën kontrata do të nënshkruhet me kandidatin e radhës për të cilin vlen gjithashtu e njëjta rregull.

V. TEKNIK LABORANT

Institucioni: QKMF “Dr.Hafir Shala” - Komuna e Drenasit/Glllogocit

Lloji i pozitës: Laborant

Numri i Pozitave: Një (1) në QKMF Drenas

Titulli i mbikëqyrësit: Shefit të njësisë, Kryeinfermierit/es, Drejtorit të – QKMF-së

Titulli: H17- Cd_277 , Grada :H17 – me Bachelor

Titulli: H20-Cd_298, Grada: H20-5 – shkollë e mesme

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pa caktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Pranon udhëzimet laboratorike, i futë të dhënat e pacientit në SISH, i përgatitë listat punuese (formularët), cakton terminet për punën me pacientë, i bartë rezultatet e analizave laboratorike në formular, librin e protokollit dhe SISH;
- Pranon mostrat nga pacienti, i regjistron dhe i shpërndan për analizat e mëtutjeshme laboratorike;
- Kryen regjistrimin paraanalitik të mostrave laboratorike dhe i sistemon ato;
- Kryen analizat kualitative dhe kuantitative të urinës duke respektuar hierarkinë e metodave analitike (veprimet e matjes);
- Kryen numërimin mikroskopik dhe elektronik (autoanalizator hematologjik) të elementeve të gjakut në bashkëveprim me Kryelaborantin ose shefin e Diagnostikës;
- Kryen analiza rutinore biokimike në bashkëveprim me Kryelaborantin ose shefin e Diagnostikës;
- Operon me aparatin për destilimin e ujit;
- Kryen sterilizimin e materialit laboratorik;
- Kujdeset për higjienën e mjeteve dhe vendit të punës;
- Zbaton dhe përdorë drejtë masat dhe mjetet mbrojtëse në punë;
- Sipas nevojës kryen punë tjera laboratorike nga kompetencat e veta profesionale;
- Respekton hierarkinë organizative dhe për punën e vet i përgjigjet Kryelaborantit.

Detyrat dhe përgjegjësitë tjera SPECIFIKE profesionale:

- Kryen pranimin dhe regjistrimin e të dhënave të pacientëve në SISH;
- Kryen punktimin venoz dhe kapilar të pacientëve, identifikon mostrat dhe i sistemon ato për punë të mëtutjeshme analitike;
- Kryen analizat kualitative dhe kuantitative të urinës duke respektuar hierarkinë e metodave analitike (veprimet e matjes);
- Kryen numërimin mikroskopik dhe elektronik (autoanalizator hematologjik) të elementeve të gjakut;
- Kryen analiza biokimike me metoda analitike si fotometria dhe punë me autoanalizator biokimik;
- Operon me aparatin e destilimit të ujit;
- Kryen sterilizimin e materialit laboratorik;
- Zbaton dhe përdorë drejtë masat dhe mjetet mbrojtëse në punë;
- I bartë të dhënat e rezultateve të analizave laboratorike në formularët përkatës si dhe në SISH;
- Sipas nevojës kryen edhe punë tjera laboratorike brenda kompetencave të veta profesionale;
- Respekton hierarkinë organizative dhe për punën e vet i përgjigjet Kryelaborantit.

Detyrat tjera dhe përgjegjësitë specifike ADMINISTRATIVE:

- Mbahet-përmbledhet administrata e tërësishme në njësinë e laboratorit;
- Regjistron pacientët dhe plotëson formularët e analizave laboratorike;
- Kryen pagesën për analizat laboratorike përkatëse në bazë të dëftesës së dhënë dhe të evidentuar;
- I fut të dhënat e pacientëve në SISH;
- I bartë rezultatet e gjetura të analizave laboratorike të pacientëve në formularë dhe libra të protokollit;
- Përgatitë raportet ditore dhe mujore;
- Shpërndanë rezultatet e analizave laboratorike të pacientëve;
- Bën kërkesat për material harxhues për nevojat e brendshme të laboratorit;
- Me urdhër të Kryelaborantit dhe Përgjegjësit të laboratorit, në kuadër të kompetencave profesionale kryen edhe punë tjera;
- Për punën e vet i përgjigjet Kryelaborantit të njësisë së Laboratorit.

Dettyra dhe përgjegjësi specifike:

- Pranon udhëzimet laboratorike, i futë të dhënat e pacientit në SISH, i përgatitë listat punuese (formularët), cakton terminet për punën me pacientë, i bartë rezultatet e analizave laboratorike në formular, librin e protokollit dhe SISH;
- Pranon mostrat nga pacienti, i regjistron dhe i shpërndan për analizat e më tutjeshme laboratorike;
- Kryen regjistrimin paraanalitik të mostrave laboratorike dhe i sistemon ato;
- Kryen analizat kualitative dhe kuantitative të urinës duke respektuar hierarkinë e metodave analitike (veprimet e matjes);
- Kryen numërimin mikroskopik dhe elektronik (autoanalizator hematologjik) të elementeve të gjakut në bashkëveprim me Kryelaborantin ose shefin e Diagnostikës;
- Kryen analiza rutinore biokimike në bashkëveprim me Kryelaborantin ose shefin e Diagnostikës;
- Operon me aparatën për destilimin e ujit;
- Kryen sterilizimin e materialit laboratorik;
- Kujdeset për higjienën e mjeteve dhe vendit të punës;
- Zbaton dhe përdorë drejtë masat dhe mjetet mbrojtëse në punë;
- Sipas nevojës kryen punë tjera laboratorike nga kompetencat e veta profesionale;
- Respekton hierarkinë organizative dhe për punën e vet i përgjigjet Kryelaborantit të Laboratorit të QKMF-së.

Kushtet dhe kriteret për Laborant:

- Teknik Laborant Hematologji-biokimi: Diploma Bachelor, Shkolla e mesme e mjekësisë (e noterizuar);
- Licenca e punës lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë- OIK,
- Dokumenti identifikues kopje,
- Të jetë banorë i Republikës së Kosovës,
- Të ketë ndjenjë përgjegjësie, i/e përkushtuar ndaj profesionit dhe ndryshimeve të këtë shkathtësi pune të pavarur dhe në ekip, si dhe shkathtësi të mira komunikimi;
- Të ketë njohuri të gjuhëve të huaja dhe të punës me kompjuter;
- Të ketë gatishmëri të punojë me të gjitha grupet, pa dallim moshe, gjinie, kulturë, etnike, religjioni apo race.

Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit i plotësuar;
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë) i fotokopjuar;
- Diplomat e kualifikimit e noterizuar;
- Licenca e punës orgjinale (e noterizuar);
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nosrifikuara diplomat Nga MASHT;
- Certifikata e kandidatit që nuk është nën hetime-origjinali,
- Kandidatët të cilët përzgjidhen nga komisioni intervistues obligohen që brenda afatit para nënshkrimit të Kontratës të sjellë në Shërbimin e Administratës së QKMF-së certifikatën shëndetësore, në të kundërtën kontrata do të nënshkruhet me kandidatin e radhës për të cilin vlen gjithashtu e njëjta rregull.

VI. TEKNIK – INFERMIER NË NJËSINË PUNUESE TË KABINETIT TË RADIOLOGJISË

Institucioni: QKMF “Dr.Hafir Shala” - Komuna e Drenasit/Glllogocit

Lloji i pozitës: Teknik-Infermier në RTG

Numri i Pozitave: Tre (3), një (1) në QKMF Drenas, dy (2) në QMF Komoran

Titulli i mbikëqyrësit: Shefit të njësisë, Kryeinfermierit/es/ Drejtorit të – QKMF-së

Titulli: H17- Cd_277 , Grada: H17– me Bachelor

Titulli: H20-Cd_298, Grada: H20-5 – shkollë e mesme

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pa caktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen triazhimin e të gjitha rasteve për ekzaminimin rentgenologjik;
- Kryen të gjitha ekzaminimet në rentgen;
- Kujdeset për funksionim të rregullt të aparaturës;
- Zbaton dhe përdorë drejtë masat dhe mjetet mbrojtëse në punë;
- Kryen pagesën e participimit për shërbimin e ofruar në bazë të dëftesës së dhënë dhe të evidentuar;
- Kryen edhe punët tjera të teknikut, infermierit sipas nevojës dhe urdhërave të Kryeinfermierit të njësisë punuese të Kabinetit të Radiologjisë;
- Për punën e vet i përgjigjet Kryeinfermierit të njësisë punuese të Kabinetit të Radiologjisë.

Kushtet dhe kriteret për Teknik të RTG-së:

- Teknik në Radiologji -Shkolla e mesme e mjekësisë, Bachelor;
- Licenca e punës lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë- OIK;
- Infermier me trajnim shtesë nga fusha e Radiologjisë (e preferuar);
- Dokumenti identifikues kopje;
- Të jetë banorë i Republikës së Kosovës;
- Të ketë ndjenjë përgjegjësie, i/e përkushtuar ndaj profesionit dhe ndryshimeve të këtë shkathtësi pune të pavarur dhe në ekip, si dhe shkathtësi të mira komunikimi;
- Të ketë njohuri të gjuhëve të huaja dhe të punës me kompjuter;
- Të ketë gatishmëri të punojë me të gjitha grupet, pa dallim moshe, gjinie, kulturë, etnike, religjioni apo race.

Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit i plotësuar;
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë) i fotokopjuar;
- Diplomat e kualifikimit e noterizuar ;
- Licenca e punës orgjinale (e noterizuar);
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nosrifikuara diplomat Nga MASHT;
- Certifikata e kandidatit që nuk është nën hetime-origjinali,
- Kandidatët të cilët përzgjidhen nga komisioni intervistues obligohen që brenda afatit para nënshkrimit të Kontratës të sjellë në Shërbimin e Administratës së QKMF-së çertifikatën shëndetësore, në të kundërtën kontrata do të nënshkruhet me kandidatin e radhës për të cilin vlen gjithashtu e njëjta rregul

VII. Shofer për nevoja (shërbime) të QKMF-së

Institucioni: QKMF "Dr.Hafir Shala" - Komuna e Drenasit/Glllogocit

Lloji i pozitës: Shofer për nevoja (shërbime) të QKMF-së

Numri i Pozitave: (1) Një

Titulli i mbikëqyrësit: Përgjegjësit të parkut të makinave/ Drejtorit të – QKMF-së

Titulli: Gj50-Cd_431, Grada : Gj50-38

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bën ngarkimin dhe shkarkimin e materialit e shpenzues shëndetësor (shpërndarjen e vaksinave, transportin e oksigjenit), administrativ dhe materialit shpenzues higjienik nga automjeti në depo , kontrollon që malli nuk është dëmtuar, informon me kohë në rast të ndonjë parregullsie tek Drejtori dhe Kryeinfermieri/ja;
- Bënë transportimin me autoambulancë rastet specifike të hemodializës;
- Mban përgjegjësi për mbajtjen me rregull të automjetit të besuar në punë, i cili është pronë e institucionit të QKMF-së dhe kujdeset për pastërtinë e tij;
- Mban evidencën në formularë të relacionit dhe kilometrat e kaluara;
- Është përgjegjës për dëmet e shkaktuara në automjet nga pakujdesia apo mospërshtatja e kushteve të komunikacionit;
- Sigurohet që të gjitha veprimet të jenë në pajtim me rregullat dhe rregulloret në rastin e përfshirjes në aksident/incident trafiku;
- Respekton dhe i përmbahet rregullores së brendshme me Nr.76/31.10.2022 për përdorimin e autoambulancave dhe automjeteve zyrtare në QKMF për përdorimin e veturave zyrtare në Institucion.
- Punonjësi është i detyruar të kryej edhe punë tjera, për të cilat punë ka përgatitje përkatëse profesionale apo aftësi të fituara në punë dhe në bazë të përvojës së punës të gjertanishme për të cilat e urdhëron Punëdhënësi ose punëtori i autorizuar nga ana e Punëdhënësit.

Kushtet dhe kriteret e nevojshme:

- Kandidati duhet ta ketë të kryer shkollën e mesme përkatëse ose ekuivalente;
- Të jetë shtetas/e i Republikës së Kosovës;
- Kandidati duhet të ketë patentë shoferi valid (të vlefshëm);
- Të ketë së paku dy (2) vite përvojë si vozitës;
- Kandidati duhet të jetë në gjendje të punojë nën presion, të ketë etikë në punë dhe integritet të lartë pune;
- Kandidati duhet të jetë në gjendje të punojë me orar fleksibil të punës;
- Kërkohej njohja e gjuhës së vendit ku shërben, ndërsa njohja e gjuhëve tjera është përparësi.

Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit i plotësuar;
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë) kopje;
- Diplomat e kualifikimit e noterizuar;

- Patentë shoferi valid (të vlefshëm) kopje;
- Certifikata e kandidatit që nuk është nën hetime-origjinali;
- Kandidati i cili përzgjidhet nga komisioni intervistues obligohen që brenda afatit para nënshkrimit të Kontratës të sjellë në Shërbimin e Administratës së QKMF-së certifikatën shëndetësore si dhe certifikatën nga Kryqi i kuq mbi trajnimin mbrojtja elementare e jetës, në të kundërtën kontrata do të nënshkruhet me kandidatin e radhës për të cilin vlen gjithashtu e njëjta rregull.

Dokumentet personale duhet të jenë në kopje, diploma dhe licenca të noterizuara, ndërsa certifikata e kandidatit që nuk është nën hetime-origjinali pasi që ato nuk kthehen. Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Konkursi është i hapur për aplikim për 30 ditë, konkretisht nga data prej dt. 07.02.2024 deri me dt. 07.03.2024.

Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda 30 ditëve duke filluar nga data 07.02.2024-07.03.2024.

Komuna e Drenasit/Glllogocit ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Aplikacionet pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Fletëaplikacionet merren në ndërtesën e QKMF-së - Zyra e Burimeve Njerëzore, kati 2.

